



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:218391
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05780777

Pml.nr.262/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsera Berisha, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit K. E., nga P., për shkak të veprës penale “Kontrabandimi me migrantë” të parashikuar me nenin 164, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.380/2023, të datës 28.12.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.17/2024, të datës 05.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit K. E., e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.380/2023, të datës 28.12.2023 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.17/2024, të datës 05.03.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.380/2023, të datës 28.12.2023, i dënuari K. E., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale

“Kontrabandimi me migrantë” e parashikuar me nenin 164, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, ndërsa në pajtim me nenin 79 të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data 15.10.2023 deri më datën 22.12.2023, të dënuarit do t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar më burgim.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.17/2024, e datës 05.03.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit K. E., avokati Muhamet Shalaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës t’i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.147/2024, e datës 02.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit K. E., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit K. E., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar fajësinë e të dënuarit në kundërshtim me dispozitat ligjore, sepse vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari nuk përbën vepër penale, pasi që i dënuari vetëm ka bërë transportimin e migrantëve brenda vendit, ndërsa një shkelje e tillë ligjore nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Mbrojtësi i të dënuarit thekson se për formën e njëjtë të veprimeve kryerëse, i dënuari K. E., ishte akuzuar edhe më parë, por me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.292/2023, të datës 27.03.2023, është aprovuar kundërshtimi i provave dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës, ashtu që ndaj të njëjtit është pushuar procedura penale.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit K. E., janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 21.12.2023, shihet se pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i dënuari K. E., e kishte pranuar fajësinë për veprës penale për të cilën ishte akuzuar, ndërsa kryetari i trupit gjykues, pas dëgjimit të mbrojtësit të të dënuarit dhe prokurorit të shtetit, kishte marr aktvendimin me të cilin e kishte miratuar pranimin e fajësisë, duke konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për një gjë të tillë, konform nenit 242, paragrafi 2 të KPP-së, ndërsa ndaj një aktvendimi të tillë, palët dhe mbrojtësi nuk kanë patur ndonjë vërejtje.

Pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se në këtë rast janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore që i referohen pranimit të fajësisë në kuptim të neneve 241 – 242 të KPP-së, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë, siç me të drejtë ka vepruar edhe gjykata e shkallës së parë, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Siç shihet edhe nga shkresat e lëndës, i dënuari K. E., ishte akuzuar dhe shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Kontrabandimi me migrantë” e parashikuar në nenin 164 të KPRK-së.

Në nenin 164, paragrafi 1 të KPRK-së është parashikuar se “Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet”, kurse në paragrafin 8, nën-paragrafi 8.1. të këtij neni është parashikuar se “Shprehja ‘kontrabandim me migrantë’ nënkupton çdo veprim me qëllim të përfuturit të drejtpërdrejtë ose të tërthorë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti”.

Gjithashtu, në kontekst të rrethanave të kësaj çështje penale, është e rëndësishme që të citohet edhe neni 164, paragrafi 8, nën-paragrafi 8.2. të KPRK-së, në të cilën është parashikuar se “Shprehja “hyrje e paligjshme” nënkupton kalimin e kufirit ose të vijës kufitare të Republikës së Kosovës pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Republikën e Kosovës ose kalim i kufijve të ndonjë shteti pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet”.

Bazuar në këto dispozita ligjore, rezulton se “hyrja e paligjshme”, në kuptim të elementeve të figurës së kësaj vepre penale, i referohet si hyrjes së paligjshme në Republikën e Kosovës, ashtu edhe hyrjes së paligjshme në shtetin në të cilin personi i tillë (migranti) nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti.

Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.I.nr.226/2023, e datës 13.12.2023 dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, shihet se i dënuari Kushtrim Elezkurtaç, më datën 15.10.2023, në ora 20:00, në Komoran, gjegjësisht në aksin rrugor Komoran-Drenas (mbi) urë, ishte ndaluar nga zyrtarët policorë, ku i njëjti, me qëllim të përfuturit të drejtpërdrejt apo të tërthorë të dobisë pasurore, në mënyrë të kundërligjshme, kishte bërë

kontrabandimin e migrantëve, duke i transportuar me automjetin e transportit “Furgon” në drejtim të Mitrovicës, gjashtëmbëdhjetë (16) shtetas Sirian dhe të cilët kishin synim për të shkuar në Serbi, e pastaj në ndonjë shtet të Bashkimit Evropian.

Nga këto që u theksuan më lart, rezulton se veprimet inkriminuese të të dënuarit Kushtrim Elezkurtaç, i përbëjnë të gjitha elementet (si subjektive, ashtu edhe objektive) të veprës penale “Kontrabandimi me migrantë” të parashikuar me nenin 164, paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që personat e kontrabanduar - gjashtëmbëdhjetë (16) shtetasit Sirian, në mënyrë të kundërligjshme, kishin për synim për të shkuar në Serbi, e më pastaj në ndonjë shtet të Bashkimit Evropian, gjë për të cilin i dënuari ka qenë në dijeni, mirëpo të gjitha këto veprime, i dënuari i kishte ndërmarrë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, për të cilat veprime edhe e kishte pranuar fajësinë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se secila çështje penale mund t’i ketë specifikat e veçanta, por e rëndësishme është se në këtë rast nuk bëhet fjalë për shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit Kushtrim Elezkurtaç, pasi që veprimet e tij i përbëjnë elementet e figurës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe shpallur fajtor

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.262/2024, më datë 16.05.2024

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi